



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo -Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura IV**

Kryesia e Kuvendit

P-046

Prishtinë, më 16 janar 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**P R O C E S V E R B A L**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 16 JANAR 2012**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletiq dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Skënder Reçica.

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

**Nga Zyra e Presidentit:** Amir Haradinaj dhe

**Nga OSBE:** Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë

### **R e n d i t e**

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 11 janar 2012,
2. Konfirmimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare, më 20 janar 2012,
3. Ndarja e hapësirave në ndërtesën e Kuvendit, aneksi C.

#### **1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 11 janar 2012**

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 11 janar 2012, u miratua pa vërejtje.

#### **2. Konfirmimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare, më 20 janar 2012**

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 11 janar 2012, ka caktuar datën e mbajtjes së mbledhjes plenare, më 20 janar 2012, si dhe rendin e ditës. Ndërkohë, në pajtim me përfundimin e Kryesisë, është propozuar edhe një projektligj për shqyrtim të dytë.

**Kryesia** konfirmoi rendin e ditës për mbledhjen plenare, më 20 janar 2012, si vijon:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Amendamentimin e Kushtetutës të Republikës së Kosovës, për mandat të ri,
5. Ratifikimi i Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim KfW, për përmirësimin e sistemeve të ngrohjes qendrore,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë,
8. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rregullimin e tokës,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Policinë.

### **3. Ndarja e hapësirave në ndërtesën e Kuvendit, aneksi C**

Sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi e njoftoi Kryesinë lidhur me propozimin e përgatitur nga Administrata e Kuvendit, për ndarjen e hapësirave në ndërtesën e Kuvendit, aneksi C, si në vijim:

#### **Propozimi i parë**

- Kati përdhes, me 12 zyra t'i ndahet deputetëve të GP, sipas numrit të deputetëve,
- Kati i parë- me 5 zyra t'i ndahet nënkryetarëve të Kuvendit dhe një (1) zyre për kryetarin e GP me më shumë deputetë, së bashku me stafin teknik dhe këshilltarët e tyre,
- Kati i dytë- me 6 zyra t'i ndahet kryetarëve të GP dhe me 6 zyra për stafin teknik mbështetës të Grupit,
- Kati i tretë- me 10 zyra, t'i ndahet kryetarëve të komisioneve parlamentare.

#### **Propozimi i dytë**

GP që kanë 20 % e më shumë deputetë, ta kenë sallën e tyre të përhershme, ndërsa grupet e tjera parlamentare do t'i shfrytëzojnë sallat e komisioneve për mbledhje të GP përkatëse.

Lidhur me propozimin e prezantuar nga sekretari i Kuvendit për ndarjen e hapësirave në ndërtesën e Kuvendit, aneksi C, diskutuan: kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, nënkryetarët e Kuvendit: Glauk Konjufca, Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, diskutimet e tyre të plota janë dhënë në transkript.

Në fund, Kryesia kërkoi nga Administrata, që të shikohet mundësia që komisionet e përhershme ta kenë nga një sallë, ndërsa nga dy komisione funksionale ta shfrytëzojnë një sallë të përbashkët, me qëllim që t'u sigurohet nga një sallë të gjitha grupeve parlamentare.

#### **Pika shtesë**

##### **1. Njoftimi i deputetes së Kuvendit, Mufera Shinik lidhur me iniciativën për formimin e Grupit të Miqësisë ndërmjet Kosovës dhe Turqisë**

Kryesia, pasi shqyrtoi iniciativën e deputetes, Mufera Shinik, lidhur me formimin e Grupit të Miqësisë ndërmjet Kosovës dhe Turqisë, vendosi që në mbledhjen e radhës të Kryesisë të emërohet kryetari i Grupit, nënkryetari dhe një sekretar administrativ, nga radha e zyrtarëve të Administratës së Kuvendit.

Gjithashtu, Kryesia diskutoi edhe për formimin e grupeve tjera të miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe parlamenteve të shtetave tjera, dhe nxori këtë

## **P Ë R F U N D I M**

Kërkohet nga grupet parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar për formimin e grupeve të miqësisë, për këto vende:

- Gjermani, Austri, Zvicër,
- SHBA- Kongresin Amerikan,
- Mbretëri e Bashkuar,
- Francë,
- Itali,
- Shtetet Skandinave,
- Maqedoni dhe Bullgari.

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:40** minuta.

Kryetari i Kuvendit

**Jakup KRASNIQI**

Procesverbalin e hartoi: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.